



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datën **12.07.2024, Nr. Akti 80**, ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: Marrjen në pyetje të personit të arrestuar **Adrian Cenaj**.
2. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Flora Hajredinaj, bazuar në nenet 248, 228, 229, 230, 244/3, 232/dh dhe 238 të Kodit të Procedurës Penale Penale, me vendimin Nr. **80**, datë **13.07.2024** vendosi:

1. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “arrest në burg” të caktuar ndaj të hetuarit **Adrian Cenaj**, i biri i Ramadan dhe i Havije, i datëlindjes 21.08.1986, lindur në Shtiqën-Kukës dhe banues në Kukës, me arsim të mesëm, me gjendje civile i martuar dhe me dy fëmijë, me gjendje gjyqësore i dënuar më parë, me kombësi e shtetësi shqipëtare, si i dyshuar për kryerje të veprës penale “Sigurimi i kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje”, në dëm të shtetasve Albert dhe Edmond Nela, kryer në bashkëpunim, në formë të grupit të strukturuar kriminal, “Grupi i strukturuar kriminal”, dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grup i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 80, 28 pika 4, 333/a dhe 334 të Kodit Penal, të caktuar me vendimin nr.76, datë 11.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Urdhërohet policia gjyqësore që ta dërgojë në një institut paraburgimi, të përshtatshëm për moshën e tij, të arrestuarin **Adrian Cenaj**.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim, në Gjykatën e Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, brenda 5 (pesë) ditëve duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

Tiranë, më datë 13.07.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

